

20240070172

МИНИСТЕРСТВО ЗА ЕКОНОМИЈА

Në bazë të nenit 120 paragrafi (6) të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve (*) ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 236/22), ministri i Ekonomisë miratoi

R R E G U L L O R E **PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E FORMULARIT PËR TËRHEQJE NGA** **MARRËVESHJA NË DISTANCË OSE MARRËVESHJA JASHTË AMBIENTEVE AFARISTE** **TË TREGTARIT (*)**

Neni 1

Kjo rregullore përcakton formën dhe përmbajtjen e Formularit për tërheqje nga marrëveshja në distancë ose marrëveshje jashtë ambienteve afariste të tregtarit.

Neni 2

Formulari për tërheqje nga marrëveshja në distancë ose marrëveshja jashtë ambienteve afariste të tregtarit duhet të dorëzohet në formë të letrës dhe elektronike. Formulari në formë të letrës është në formatin A-4 në letër të bardhë, ndërsa formulari në formë elektronike është në word dokument.

Forma dhe përmbajtja e Formularit nga paragrafi 1 i këtij neni janë dhënë në Shtojcën, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon të jetë e vlefshme Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e Formularit për tërheqje nga marrëveshja në distancë ose marrëveshje e lidhur jashtë ambienteve afariste të tregtarit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.206/15).

Neni 4

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 25-147/1
4.1.2024
Shkup

Ministri i Ekonomisë,
Kreshnik Bekteshi, d.v.

(*) Me këtë rregullore bëhet harmonizimi me Direktivën nr. 2011/83/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2011 për të drejtat e konsumatorit, CELEX nr.32011L0083.

Shtojca

Tërheqja nga marrëveshja në distancë ose marrëveshja jashtë ambienteve afariste të tregtarit nga konsumatori

(ky formular duhet të plotësohet dhe të dërgohet vetëm nëse dëshironi të tërhiqeni nga marrëveshja)

— Emri dhe selia e tregtarit, numri i telefonit, adresa e postës elektronike ose numri i telefonave (këto të dhëna i shënon tregtari); _____

— Me këtë unë/ne^(*) njoftoj/njoftojmë për tërheqjen time/tonë^(*) nga marrëveshja e shitjes së mallrave/shërbimeve si vijon (*); _____

— Dorëzuar _____ (*)/pranuar më _____ (*) ;

— Emri dhe mbiemri, respektivisht emri i konsumator(it)/(ëve) _____

— Adresa e konsumator(it)/ (ëve); _____

— Nënshkrimi i konsumator(it)/ (ëve) (vetëm nëse ky formular plotësohet në letër)

— Data

U d h ë z i m

për plotësimin e formularit për realizimin e së drejtës për t'u tërhequr nga marrëveshja në distancë ose marrëveshja jashtë ambienteve afariste të tregtarit , të përpiluar nga tregtari

Konsumatori mund të realizojë të drejtën e tërheqjes nga marrëveshja, respektivisht të ndërprerë marrëveshjen e lidhur me tregtarin që lidhet në distancë ose marrëveshje jashtë ambienteve afariste të tregtarit në afat prej 14 ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes ose në afat prej 30 ditëve nëse kjo marrëveshje është lidhur gjatë një vizite të paparalajmëruar në shtëpinë tuaj në shtëpi ose gjatë ekskursioneve të organizuara me qëllim të promovimit ose shitjes së mallrave për konsumatorët, pa dhënë me këtë rast arsye ose arsyetim për tërheqjen nga marrëveshja dhe pa detyrimin e tij për të paguar çfarëdo shpenzimesh

Periodha e tërheqjes skadon pas 14 ditësh, respektivisht 30 ditë nga dita e përfundimit të marrëveshjes.

Për ta realizuar të drejtën e tërheqjes, duhet të na informoni për vendimin tuaj për të ndërprerë këtë marrëveshje me deklaratë të qartë (p.sh., letër të dërguar me postë, me faks ose postë elektronike). Për këtë qëllim, mund të përdorni ekzemplarin e dorëzuar të formularit për tërheqje.

Për të respektuar Marrëveshjen e tërheqjes, mjafton që të na dërgoni formularin në raport me realizimin e së drejtës së tërheqjes para skadimit të afatit për tërheqje.

Efektet e tërheqjes

Nëse tërhiqeni nga kjo kontratë, kompensohen të gjitha pagesat që i kemi marrë, duke përfshirë kostot e dorëzimit (me përjashtim të kostove shtesë që mund të rezultojnë nga zgjedhja juaj eventuale në formë të dorëzimit përveç llojit më të lirë të dorëzimit standard nga ajo që është ofruar), pa vonesa të panevojshme dhe në çdo rast jo më vonë se 14 ditë nga dita kur jemi të informuar për vendimin Tuaj për t'u tërhequr nga kjo marrëveshje. Kompensimet e tilla do të bëhen duke përdorur mjetin e njëjtë të pagesës që keni përdorur gjatë transaksionit fillestar, përveç rasteve kur është dakord ndryshe në mënyrë të qartë. Në çdo rast, ju nuk do të bëni kurrfarë shpenzimi si pasojë e atij kompensimi.

Udhëzime për plotësim:

1.Vendosni njërin nga testet si vijon ndërmjet dhonjësive:

a) "lidhja e marrëveshjes" - në rast të marrëveshjes për shërbime ose marrëveshje për furnizimin e ujit, shuan energjinë elektrike, kur nuk ofrohen për shitje në sasi të kufizuara me cilësi të caktuar, ngrohje qendrore ose përmbajtje digjitale që nuk i dërgohet bartësit të qëndrueshëm;

b) "në të cilin Ju ose ndonjë person i tretë, përveç transportuesit dhe personit të emëruar nga Ju, përvetëson zotërimin fizik të mallrave", në rast të marrëveshjes së shitjes;

c) "në të cilin Ju ose palë e tretë, përveç transportuesit dhe personit të emëruar nga Ju, përvetëson zotërim fizik të mallit të fundit", në rast të një marrëveshjeje për më shumë mallra të porositura nga konsumatori në një porosi ndërsa të dorëzuar veçmas:

ç) "në të cilin Ju ose person i tretë, përveç transportuesit dhe personit të emëruar nga ju, përvetësohn zotërim fizik të dërgesës ose copës së fundit", në rast të një marrëveshjeje për dërgimin e mallit që përbëhet prej më shumë dërgesave ose copëve:

d) "në të cilin Ju ose palë e tretë, përveç transportuesit dhe personit të emëruar nga Ju, përvetëson zotërim fizik të mallit të të parë" në rast të një marrëveshjeje për dërgimin e rregullt të mallrave gjatë një periudhe të caktuar kohore.

2.Vendosni emërtimin, selinë dhe, nëse janë të arritshme, numrin e telefonit dhe numrin e faksit dhe adresën elektronike.

3. Nëse i jepni konsumatorit mundësinë për të plotësuar dhe dorëzuar informacionin elektronik për tërheqjen e tij nga marrëveshja në faqen tuaj të internetit, vendosni si vijon: "Gjithashtu, mund të plotësoni dhe dorëzoni ekzemplarin elektronike: formularin e tërheqjes dhe çfarëdo deklarate tjetër të qartë në faqen tonë të internetit (vendosni adresën). Nëse e përdorni këtë opsion, ne do t'ju sigurojmë pa vonesë konfirmimin e pranimit të tërheqjes në bartës të qëndrueshëm të të dhënave (për shembull përmes postës elektronike)."

4. Për marrëveshjet për shitje në të cilët keni ofruar të merrni përsipër mallrat në rast të tërheqjes, vendosni si vijon: "Kompensimi mund të pezullohet për pranimin e mallrave ose derisa të provohet se mallrat janë kthyer, pavarësisht se çfarë ka ndodhur së pari".

5. Nëse konsumatori ka pranuar mallrat që janë lëndë e marrëveshjes:

a) Shënoni:

- "Do t'i kthejmë mallrat". ose

- "Ktheni mallrat ose dorëzoni ... (shënoni emërtimin, selinë, nëse është e përshtatshme, të personit të autorizuar nga Ju për të pranuar mallrat), pa vonesa të panevojshme dhe në çdo rast brenda 14 ditëve nga dita kur na njoftoni për tërheqjen tuaj nga kjo marrëveshje. Afati përfundimtar nëse na i ktheni mallrat para skadimit të afatit prej 14 ditëve."

b) Shënoni:

- "Shpenzimet për kthimin e mallrave do të jetë në llogarinë tonë",

- "Shpenzimet e drejtpërdrejta për kthimin e mallrave do të jenë në llogarinë tuaj.",

- Nëse, në marrëveshjen në distancë, Ju ofroni të paguani koston e kthimit të mallrave dhe ato, nga natyra e tyre, nuk mund të kthehen normalisht me postë: "Kostoja e drejtpërdrejt nga EUR (shënoni vlerën) për kthimin e mallrave do të jetë në llogarinë Tuaj."; ose nëse kostoja e kthimit të mallrave nuk mund të përlllogaritet në mënyrë të arsyeshme paraprakisht: "Kostoja e drejtpërdrejtë e kthimit të mallrave do të jetë në llogarinë tuaj. Kostoja përlllogaritet

- në maksimum nëse... EUR (shëno vlerën)", ose

- Nëse, në rastin e një marrëveshjeje të lidhur jashtë ambienteve afariste, mallrat, nga natyra e tyre, nuk mund të kthehen normalisht me postë dhe janë dorëzuar në shtëpinë e konsumatorit sigurohet në datën e lidhjes së marrëveshjes: "Mallrat do t'i marrin përsipër në llogarinë tonë."

c) Shënoni: "Ju jeni i vetmi përgjegjës për zvogëlimin e vlerës së mallrave si rezultat i menaxhimit të mallrave ndryshe nga sa është e nevojshme për të përcaktuar natyrën, karakteristikat dhe funksionalitetin e mallrave."

6. Në rastin e marrëveshjes për dërgesën e ujit, gazit ose energjisë elektrike kur nuk ofrohen për shitje në sasi të kufizuar ose cilësie të caktuar, ose ngrohje qendrore, shënoni si vijon: "Nëse keni kërkuar të fillojë ushtrimi i shërbimit ose furnizimi me ujë/gaz/energji elektrike/ngrohje qendrore (fshini atë që nuk është e nevojshme) gjatë afatit për tërheqje, jeni të detyruar të na paguani vlerë proporcionale të asaj që është dërguar deri në momentin kur ju na keni njoftuar për tërheqjen Tuaj nga kjo marrëveshje, në raport me të gjitha rrethanat e parashikuara me marrëveshjen."